

RAPORT PER KONTROLLIN E BREND SHEM
VITI 2012

Tirane, 25 MAJ 2013

Organizimi, Kontributet, Pronesia, Kapitali dhe Administrimi

Organizimi

Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar (IEKA) eshte krijuar ne vitin 1997 si nje grupim profesionistesh te cilet auditojne pasqyrat financiare si dhe kryejne misione ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Veprimtaria e IEKA rregullohet sipas Ligjit nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar” si dhe nga Statuti i tij dhe legjislacioni perkates ne fuqi.

Kontributet

Instituti i Eksperteve Kontabel ka nje kontribut, i cili eshte i formuar kryesisht nga kuotat e derdhura te anetareve te tij, si dhe burime te tjera, te njohura nga Asambleja e Pergjitheshme qe per vitin 2012 jane:

Kuota Fikse 100,000

Kuota Variabel 1%

Pronesia dhe Pajisjet

Instituti zoteron nje pronesi qe eshte e perbere nga ndertesa, mjete transporti dhe inventar ekonomik.

Kapitali

Pasuria Neto ne fund te ushtrimit paraardhes eshte 93,494,673leke.

Administrimi

Instituti drejtohet nga Keshilli i Drejtimit i cili vepron ne perputhje me ligjin nr. 10 091 dt. 05.03.2009.

Politikat Kontabel

Pasqyrat Financiare jane pergatitur ne perputhje me ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar dhe me parimet kontabel te pershtatura nga Asambleja e Pergjitheshme dhe Keshilli i Drejtimit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike dhe parimit te arketimeve dhe pagesave. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Leke Shqiptar “LEK”.

I. Aktivet Afatshkurtera ne Shumen 56,004,688 leke perfaqesojne :

Aktivet afatshkuretra monetare ne shumen 52,819,623 leke jane paraqitur ne bilanc me gjendjen e llogarive bankare dhe arkes ne daten e fundit te vitit konvertuar me kurset \$ = 105.85 leke dhe EUR = 139.59 leke. Instituti ka llogari bankare ne leke e valute ne Banken Raiffeisen, Banken Kombetare Tregetare dhe ne Intesa Sanpaolo Bank.

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>
Para ne dore	113,669	195,718
Para ne Banka	12,416,539	12,900,950
Depozita me afat	40,289,415	38,435,320
Totali	52,819,623	51,531,988

Konstatime: Gjate vitit 2012 transaksionet ne llogarite bankare te IEKA-s jane kryer me nje firme.(Firma e Drejtorit Ekzekutiv ose Firma e Kryetarit te Keshillit te Drejtimit ose Nen/Kryetarit te Keshillit te Drejtimit).

Rekomandohet: Transaksionet Bankare te firmosen nga Drejtori Ekzekutiv dhe Financieri i IEKA-s

Aktive te tjera financiare afatshkurtera ne shumen 2,110,724 leke perfaqeson kerkesa per arketim mbi debitoret ne bilanc, e cila paraqitet ne bilanc me vleren e tyre te arketueshme si me poshte:

	<u>31 Dhjetor 2012</u>	<u>31 Dhjetor 2011</u>
EKR kuote fikse pjesore (18)	818,347	
EKR penalitete kuota fikse	160,240	
EKR pasiv kuote fikse	947,137	
Stazhiere per pagesen e testimit(8)	61,000	
Stazhiere per pagesen e ritestimit (6)	12,000	
sig. Shoqerore parapagim leje lindje	96,000	
Stazhiere per pagesen e traj	0	52,000
EKR (Radika)	0	38,070
EKR per testin CPD	16,000	16,000
Totali	2,110,724	106,070

Invetare(Revista,SNA,K Etikes) ne shumen 1,074,340 lek perfaqeson gjendjen e tyre ne bilanc e cila paraqitet me cmimin e shitjes, e cila detajohet si me poshte:

INSITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE AUTORIZUAR (IEKA)
Raport për Kontrollin e Brendshëm 2012

		31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2011
Kodi Etikes	294	267,540	391,660
SNA	245	509,600	832,180
Revista	2.972	297,200	297,600
		1,074,340	1,521,440

2 AKTIVET AFATGJATA.

Aktive afatgjata materiale zene nje vlere prej 48,780,048 leke. Ato paraqiten:

- Ndertesa me vlere 42,709,900 leke;
- Mjete transporti me vlere 364,440 leke.
- Paisje zyre dhe informatike ne vlere 5,705,708 leke,

Aktivet afatgjata materiale jane prone e IEKA dhe jane paraqitur ne bilanc me vleren e tyre historike minus amortizimin e akumuluar.

Ndertesa akoma nuk eshte regjistruar ne Zyren e ZRPP.

Gjate vitit ushtrimor ka patur shtesa ne Aktivet e qendrueshme ne vleren 1,010,761 leke te cilat jane blere nga IEKA si dhe shtesat e perfituara nga Projekti REPARIS ne Shumen totale 3,417,248 leke nga te cilat jane per Institutin ne vleren 1,155,000 leke, per BMP ne vleren 1,910,630 leke dhe per AC ne vleren 351,618 leke.

Konstatime: Blerjet e Aktiveve Afatgjata Materiale jane bere pa procedura te percaktuara, dhe te shkruara.

Rekomandohet: Transaksionet e blerjeve te AAM te behen me procedure blerjesh.

3. DETYRIMET AFATSHKURTERA

Detyrimet Afatshkurtera ne shumen 11,290,063 leke detajohen si me poshte:

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2011
Detyrime ndaj Furnitorëve	2,045,870	2,466,963
Detyrime ndaj AC	5,848,490	3,709,901
Detyrime tatimore	315,703	375,562
Te ardhura te ushtrimeve te tjera	3,080,000	1,530,000
Totali	11,290,063	8,082,426

4. KAPITALI (PASURIA NETO)

Ne kete post te pasqyrave financiare perfshihet pasuria neto e trasheguar i IEKA ne Shumen 93,297,387 leke e cila eshte shtuar per vleren 3,417,248 leke per Shumen e pajisjeve te dhena ne formen e nje granti nga Projekti REPARIS dhe eshte pakesuar me shumen 976,459 leke per te perballuar shpenzimet e kualifikimit te vijueshem te anetareve sipas vendimit nr.37 te dates 28.05.2012 dhe me Uljen e teprices se vitit 2012 ne vlere 2,243,503 leke .

5. Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

	Buxheti 2012	Realizimi 2012	Realizimi %
Te ardhura nga Kuotate EKR	20,700,000	24,857,571	120%
Te ardhura nga Stazhieret	2,500,000	3,150,000	126%
Te ardhura te tjera	600,000	1,753,450	292%
Total te ardhura veprimtari kryesore	23,800,000	29,761,021	125%
Te ardhura nga botimet	700,000	421,468	60%
Kualifikimi I e.k.r & k.r.	2,500,000	1,424,720	57%
Total te ardhura	27,000,000	31,607,209	117%
Paga	8,440,000	5,999,023	71%
Honorare Drejtimi	3,030,000	2,661,314	88%
Honorare Autoritete e Komitete	1,950,000	2,973,850	153%
Komitete per SNA	500,000	-	0%
Shpenzime Botimi	400,000	-	0%
Shpenzime Administrative	10,150,000	19,707,926	194%
Auditimi	200,000	99,612	50%
Investime&Meremetime	650,000	28,000	4%
Rezerve e KD	500,000	500,000	100%
Totali 1	25,820,000	31,969,725	124%
Botime & Konferenca	7,600,000	4,244,400	56%
Total Shpenzime	33,420,000	36,214,125	108%
Teprica (Ulja) fondeve	(6,420,000)	(4,606,916)	72%
Te ardhura nga Depozitat	1,000,000	2,363,412	236%
Teprica (Ulja) fondeve	(5,420,000)	(2,243,504)	41%

Konstatime: Gjate kontrollit te shpenzimeve u vu re se :

-Mungojne procedurat e blerjeve, si dhe rregullore per blerjet.

-Shpenzimet e Zerit 2.1.3.3 Bordi i Mbikqyrjes Publike shpenzime ne vlere 1,150,750 jane me Vendim Te Keshillit te Drejtimit Nr. 72 dt.04.11.2011 (leke 600,000) Nr.13 dt.12.03.2012, (leke 200,000) dhe Nr 11 dt 23.12.2012 (Euro 2,500). Keto vendime jane ne kundershtrim me Statutin e Shoqates “Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar” Neni 15 Pika 2.26.

-Shpenzime Udhetimi Turistik ne vlere 9,392,425 leke miratuar me Vendim keshilli Drejtimi Nr.31 dt 2.05.2012. Ky vendim eshte ne kundershtrim me Statutin e Shoqates “Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar” Neni 15 Pika 2.26.

-Eshte konstatuar tejkalmi ne 9 zera te buxhetit mbi 20% dhe per keto tejkalime nuk ka asnje procedure per regullimin dhe miratimin paraprak te buxhetit. Kjo eshte ne kundershtrim me Statutin e Shoqates “Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar” Neni 15 Pika 2.26.

Rekomandohet: Transaksionet e blerjeve te behen me procedure blerjesh. Keshilli i Drejtimit te mos shkele kopetencat e tij ne baze te Statutit te Shoqates “Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar” Neni 15 Pika 2.26.

Konstatime te Tjera

-Ne baze te Statutit te Shoqates “Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar” Neni 15 Pika 2.12 dhe 2.14 dhe Neni 26 pika 2 Keshilli i drejtimit nuk ka pergatitur akte veteregullatore si dhe Regulloren e brendeshme per funksionimin e organeve te institutit.

-Drejtimi i Institutit i ka paraqitur gjate vitit 2012 Raport per gjendjet financiare te tremujorit dhe realizimin e buxhetit tremujor Kryetarit te Keshillit te Drejtimit. Keshilli i Drejtimit ka mare ne shqyrtim vetem Analizen financiare te 10 mujorit.

-Mbas muajit Qershor 2012 deri me 31 Dhjetor 2012 nuk ka procedura per Emerimin e Drejtorit Ekzekutiv te IEKA .

PER KOMITETIN E KONTROLLIT TE BRENDESHEM

Stoli Laze

Tatjana Filto

Eksperte Kontabel te Regjistruar